



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Ligjshmërisë

Data	
Nr. Prot	

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 3, DATË 06.11.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE ZHVILLIMIT TË
SEANCAVE TË KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE", TË NDRYSHUAR**

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Neni 20, pika 1, shkronja "d", i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregulloren e mbledhjeve të Rregullatorit dhe rregulloren e seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

II. PËRMBLEDHJE SHPIEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektakti përmban një ndryshim në vendimin nr. 3, datë 6.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e rregullores "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve", të ndryshuar".

Ky ndryshim vjen si nevojë për të detajuar të drejtën e ankimit në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt ankimi.

Vendimi nr. 1, i datës 22.1.2022, i Komisionit Rregullator, "Për një shtesë në vendimin nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e rregullores "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve", në fund të pikës 8, të nenit 9, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020, shtoi fjalinë me këtë përmbajtje:

- a) "...Për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjeshme, afati i ankimit 3 (ditë), i përcaktuar në pikat 1, 7 dhe 8, të këtij neni, bëhet 24 (njëzetë e katër) orë..."

Projektakti i propozuar për miratim përmban këtë ndryshim:

Fjalja e fundit e pikës 8, të nenit 9, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, ndryshohet si më poshtë vijon:

- a) “...Për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme, apo në rastin e përsëritjes së zgjedhjeve, afati i ankimimit 3 (ditë), i përcaktuar në pikat 1, 7 dhe 8, të këtij neni, bëhet 24 (njëzetë e katër) orë...”.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet administratës së KQZ, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të ndryshuar”.

Sekretar i Përgjithshëm

Ylli MERKAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: .7.2023

Nr:

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 3, DATË 06.11.2020, TË KOMISIONIT
RREGULLATOR, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT
DHE ZHVILLIMIT TË SEANCAVE TË KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE",
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja "d", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Fjalja e fundit e pikës 8, të nenit 9, të Rregullores "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve", miratuar me vendimin nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:
 - a) "...Për zgjedhjet e parakohshme dhe/ose të pjesshme, apo në rastin e përsëritjes së zgjedhjeve, afati i ankimit 3 (ditë), i përcaktuar në pikat 1, 7 dhe 8, të këtij neni, bëhet 24 (njëzet e katër) orë...".
2. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

Data: ..2023 Nr:
Ora:00.00



"Për një ndryshim në vendimin nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e rregullores "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, të ndryshuar"